

Metodologjia Montessoriane

Alternativat e edukimit sipas metodës montessoriane, synon të zhvilloj një metodë edukimi e cila nxitë zhvillimin natyral të fëmijës. Andaj, veprimtaritë dhe teknikat e saja janë, përpiluar në mënyrë që të zhvillojnë pavarsinë tek fëmija.

Montesori mbronte lirinë me përgjegjësi, me fitimin e lirive të reja, fëmijët kuptojnë se vijnë përgjegjësi të reja.

Montesori njohu dhe pranoi rolin e mjedisit në zhvillimin njohës të fëmijës. Teoritë e saja janë pragmatike në lidhje me debatin natyrë/edukim. Ajo e vinte theksin në motivim të brendshëm dhe pandashmërinë e mendjes dhe trupit, mendimit dhe veprimit.

Roli i edukatores shihet si shërbyes dhe jo komandues. Ajo shihet si kujdestarë , si lehtësuese, si vëzhguese.

Montesori e shikonte mendjen e fëmijës si të vecantë dhe unike. koncepti i mendjes thithëse i referohet konceptit të fëmijës për të integruar në vetëvete informacionin për botën reale dhe për të zhvilluar disa shprehje dhe aftësi. Një mjedis i pasur kulturor stimulon mendjen e fëmijës dhe thithja ndodh në mënyrë të natyrshme, mendja thithëse e fëmijës është e zënë në ndërvrprimin me mjedisin duke shfaqur parapëlqime për disa lloje përvojash mbi disa tjera.

Montesori zhvilloi një model në rritje. I cili dukej i qëndrueshëm më maturimin e përgjithshëm të fëmijëve .

Teoria e periullave të ndryshme mbron pikëpamjen se fëmijët zhvillohet në renditje të caktuar dhe jo rastësisht.

Për përshtatjen rritjen e mendjes thithëse të fëmijës, montesori zhvilloi atë që e quajti mjedis i përgatitur. Ky është një mjedis mësimor që nxit nevojat unike të fëmijës për të nxënë.

Liste e teknikave, materialeve dhe koncepteve te perdoruar nga maria montesori

-Fëmijët mësojnë nëpërmjet lojës, e cila nënë të mundur zhvillimin dhe përdorimin e lojërave edukative NË EDUKIMIN E HERSHËM, GJË QË STIMULON TË LEXUARIT TË SHKRUARIT DHE BAZAT E MATEMATIKËS NË MOSHAT E HERSHME.

- Përdorimi sipas përmasave të fëmijës është tregues që gjendja aktuale e fëmijës vlerësohet respektohet dhe i përshtatet atij.
- Fëmijët grupohen më tepër sipas aftësisë, kurse sipas moshës duke marrë edhe udhëzime individuale. Kështu fëmijës i jepen mundësi duke i hapë horizont të reja vetës.

- Më tepër se një fëmijë në rritje , çdo fëmijë shihet nga të rriturit si unik.
- Mjedisi luan rol të rëndësishëm gjatë procesit të të mësuarit.
- Fëmijët gjejnë kënaqësi natyrale kur mësojnë ta sundojnë mjedisin që i rrethon. Ky studim, i cili fillon me manipulimin e objekteve, është baza e ndjenjës së kompetencës, çka është e domosdoshme për t'u ndier i pavarur.
- Të mësuarit e vërtetë përmbledh aftësinë për të bërë gjëra për veten dhe jo marrjen në mënyrë pasive të një sërë njohurive.
- Mjet me të cilin mësojnë fëmijët, materiale mësimore të tyre, duhet të jenë tepër tërheqëse në mënyrë që ata t'i gjejnë vetë gabimet. Nëpërmjet tyre duhet t'u aftësohen shqisat në perceptimin dhe në fitimin e aftësive për të përballur realitetin.
- Heshtja dhe pasiviteti i imponuar e pengon të mësuarit tek fëmijët, nëse fëmijëve u jepen për të bërë punë interesante, atëherë ata do të vendosin rregullin dhe qetësinë e tyre.
- Koncepti i periullave të ndjeshme, i fazave të zhvillimit në përshtatje me fitimin e aftësive njohëse dhe specifike motorike, të tilla si gadishmëri për të lexuar.
- E drejta e çdo fëmije për të zhvilluar potencialin e tij të plote, dhe ideja se shkolla egziston që të mbrojë dhe të vërë në zbatim këtë të drejtë.
- Ideja se shkolla duhet të jetë pjesë e komunitetit dhe duhet të përfshihen prindërit nëse duam që edukimi të jetë i efektshëm.

Metoda e Montessorit synon një program të përbërë nga trinomi: fëmijë- mjedis – mësues.

Ajo i nënkupton një rol të Ri të të mësuarit dhe një ndërveprim të fëmijës me njerzit brenda një mjedisi të pajisur mirë me materiale, që reflektojnë synime të caktuara.

Metoda e mësimit të Montesorit bazohet në edukimin shqisor sipas të cilit fëmija mëson në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur (nga edukatori).

Fëmijët e vegjël mësojnë nëpërmjet eksplorimit.

Qendrat mësimore, janë një mënyrë e mirë për t'u krijuar fëmijëve të vegjël mundësinë e eksplorimit, për të cilin ata kanë nevojë gjatë procesit të të mësuarit.

Qëllimi, balanca dhe integrimi i kurrikulës, janë të pranishëm në të gjitha qendrat mësimore, të cilat u krijojnë fëmijëve mundësinë për ta konsideruar të mësuarit në mënyrë praktike dhe kuptimplotë.

Qendrat mësimore jane:

qendra shqisore/ndërtimore,

qendra e formimit praktik (ujë dhe rërë, veprimtari në tavolinë),

qendrat gjuhësore,

qendrat e matematikës,
punishte etj.

Loja mësimore mund të zhvillohet brenda klasës dhe jashtë saj.

Ajo ndihmon fëmijën në zhvillimin e tij shoqëror, duke i krijuar mundësinë e bashkëpunimit me bashkëmoshatarët e tjerë .

Mësuesja duhet të bëjë kujdes që pjesa më e madhe e të mësuarit të kryhet nëpërmjet ndërveprimit të fëmijës me mjedisin.